



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 29.9.2008, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit**

Në mbledhje **morën pjesë**: Lulzim Zeneli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Zulfi Merxha, Zef Morina, Ali Lajçi, dhe Myrvete Pantina. **Mungoi** : Ibrahim Selmanaj, Selvie Halimi dhe Kosara Nikoliq (në mbledhjen tjetër).

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga MBPZHR : Isah Rudaku , nga OSCE Blerim Vela

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Drita Çarkaxhiu, Lule Ymeri

Mbledhjen e kryesoi : **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i projektligjit për Inspektionin Bujqësor,**
- 3. Të ndryshme.**

**Kryetari**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës,

**1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Kryesuesi**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së kaluar pa vërejtje.

**2. Shqyrtimi i projektligjit për Inspektionin Bujqësor**

Në fillim zyrtari nga MBPZHR , sipas kërkesës së Kryetarit, sqaroi komentet të cilat janë dhënë në bazë të sugjerimeve të këtij komisioni, ndaj ato u miratuan si vijon :

**Amendamenti 1**

Preambula riformulohet:

“**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

**Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,**”

**Amendamenti 2**

Neni 2, në pikën 6 në reshtin e dytë pas fjalës “inspektionin” shtohet “e nivelit”, në pikën 8 përmirësohet fjala “Pylltarisë” dhe bëhet “Pylltarisë”, në pikën 9 përmirësohet fjala “nkupton” e cila bëhet “nënkupton”.

#### **Amendamenti 3**

Neni 3, riformulohet si vijon :

Inspektori kryen punët inspektuese në fushat e **bujqësisë**:

1. **tokat** bujqësore;
2. pylltarisë dhe gjuetisë;
3. mbrojtjes së bimëve;
4. blegtorisë dhe peshkatarisë;
5. veterinarisë **dhe sigurisë së ushqimit.**

#### **Amendamenti 4**

Neni 4, paragrafi (2), riformulohet si vijon :

Inspekcioni përbëhet nga:

1. Inspekcioni për **tokën** bujqësore;
2. Inspekcioni për pylltari dhe gjueti;
3. Inspekcioni për mbrojtjen e bimëve – inspekcioni fitosanitar -
4. Inspekcioni për blegtori dhe peshkatari
5. Inspekcioni për veterinarë **dhe siguri të ushqimit.**

#### **Amendamenti 5**

Neni 5, paragrafi 1, pas fjalës “inspektorët” shtohet “e nivelit qendror”, dhe pas fjalës “territorin” shtohet “Republikës së”.

#### **Amendamenti 6**

Neni 7, paragrafi 1, në fillim fjala “është i autorizuar të”, **fshihet.**

#### **Amendamenti 7**

Neni 8, fjala e fundit e këtij neni “trakes” zëvendësohet me “shiritit”.

#### **Amendamenti 8**

Neni 11, fjalia “dispozita ligjore” zëvendësohet me “akte nënligjore”, ndërsa te Neni 13, paragrafi 2, në reshtin e 2, pas “me” shtohet “këtë”.

#### **Amendamenti 9**

Neni 15, paragrafi 1, në reshtin e parë pas “kryerjen” shtohet lidhësja “e”, paragrafi 2 riformulohet : “**Punët e caktuara tekniko-profesionale si ekspertizë, hulumtime laboratorike, mund të kryhen në institucionet e specializuara.**”

#### **Amendamenti 10**

Neni 16, paragrafi 1, fjalia “Shërbimit Policor të Kosovës” zëvendësohet me “Policisë së Kosovës”.

#### **Amendamenti 11**

Neni 23, paragrafi 2, riformulohet :

“**Procedurat e marrjes së mostrave përcaktohen me akt nënligjor.**”

Neni 27 u kërkuar nga Elheme Hetemi dhe Zef Morina të fshihet për shkak të duplikimit të dispozitave, ndaj komisioni arsyetoi vetëm fshirjen e paragrafit 1.

#### **Amendamenti 12**

Neni 27, fshihet paragrafi 1.

#### **Amendamenti 13**

Neni 30, afati “një viti” zëvendësohet me “**9 (nëntë) muaj**”, ndërsa në fund pas fjalës “zbatimin” fjala “e tij” zëvendësohet me “**këtij ligji**”.

#### **Amendamenti 14**

Neni 32, riformulohet sipas standardit të kushtetutës në fuqi : “**Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.**” duke e fshi paragrafin 1.

### **Të ndryshme**

**Lulzim zeneli** njoftoi komisionin se Kryesia e Kuvendit ka miratuar raportet e këtij komisioni për të shqyrtuar seanca plenare më 3 tetor rekomandimet rreth “Prevallës” dhe “Pyjeve të Deçanit”, ndaj i ftoi që të kontribuojnë në këtë drejtim në këtë seancë. **Elheme Hetemi** ishte në dilemë se a është sqaruar mjaft se a kemi të bëjmë me “park nacional” apo “fshat turistik”,

ndërkaq **Zef Morina** tha se nuk janë dhënë mjaft sqarime nga Komuna e Prizrenit dhe MMPH. Megjithatë **Lulzim Zeneli, Berat Luzha etj** sqaruan se në këto dy raste ky komision kërkon vetëm zbatimin e ligjshmërisë dhe ndërmarrjen e masave të duhura nga MMPH përkatësisht MBPZHR. Me këtë rast , vazhdoi kryetari, kryesia është pajtuar se kërkesa e komisionit është mjaft e qartë, ndaj nuk ka pasur arsye pse mos të rendit këtë në seancën e radhës. **Berat Luzha** tha se nuk kanë pasur sukses disa tentime në kryesi që këto raste të kualifikohen me karakter politik, ngase kemi të bëjmë me një vend për rekreacion (Prevala) e jo vendbanim të ndonjë komuniteti. Kërkesa (iniciativa) e këtij komisioni, vazhdoi ai, duhet të ketë vetëm karakter të zbatimit të ligjshmërisë, sepse ky park me ligj është shpallur më 1986 dhe është e regjistruar në IUCN.

**Lulzim Zeneli** njoftoi komisionin për vizitën shumë të suksesshme të delegacionit të këtij komisioni në parlamentin Kroat, nga e cila janë marr përshtypje shumë të mira për problemet aktuale në dy vendet, edhe pse Kroacia dhe Kosova për nga vëllimi i punëve shumë ndryshojnë. Me këtë vizitë është arritur që problemet tona, sidomos mjedisore, të diskutohen në aspektin e tejkalimit të vështirësive. Ai tha se raporti është dërguar secilit anëtarë, por kërkoi nga administratori i komisionit një raport më të shkurtë për të njoftuar edhe Kryesinë e Kuvendit për rezultatet e kësaj vizite, ngase kjo praktikë duhet të behet në Kuvendin tonë, në mënyrë që mos të ndodhë që askush mos të njoftohet për vizitat e bëra.

Pasi nuk kishte diskutime tjera, mbledhja e radhës u caktua në terminin e rëndomtë për të martën , kur do të filloi komisioni shqyrtimin e projektligjeve mjedisore.

Mbledhja përfundoi në orën 13,50

Kryesuesi i Komisionit,  
**Lulzim Zeneli**